



GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI

Numri i lëndës: 2024:051630  
Datë: 25.03.2024  
Numri i dokumentit: 05496988

**C.nr.859/2024**

**GJYKATA THEMELORE GJILAN-DEGA V.**, gjyqtari Alush Sinani, me bashkëpunëtoren profesionale Dardana Behluli, në çështjen juridike kontestimore të paditësit Z.S.nga fshati B., Komuna V., i përfaqësuar nga G.R., avokat në V., kundër të paditurës Komuna V.-Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti kompensimi i shpenzimeve të ushqimit, vlera e kontestit 480 €, jashtë seancës, me datë 22.03.2024, mori këtë:

**AKTGJYKIM**

I. Aprovohet e bazuar kërkesëpadia e paditësit Z.S.nga fshati B., Komuna V. dhe detyrohet e paditura Komuna e V.së që paditësit, në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit t'ia paguajë shumën 480 €, për 240 ditë pune, për periudhën nga data 21.01.2021 deri më 21.11.2022, me kamatë ligjore në lartësi 8 %, e llogaritur nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën përfundimtare, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit ligjor.

II. Detyrohet e paditura që paditësit t'ia paguajë shpenzimet e procedurës në shumën 99 €, në afat prej 7 ditëve nga pranimi i aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit ligjor.

**Arsyetim**

Paditësi, përmes përfaqësuesit së tij, me datë 13.02.2024, në këtë gjykatë ka ushtruar padi kundër të paditurës, me objekt kontesti kompensimi i shpenzimeve të ushqimit, vlera e kontestit 480 €.

Në padi ka theksuar se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura, përkatësisht në ShFMU "A.H." në fshatin B., Komuna V., andaj, nga gjykata ka kërkuar që të detyrohet e paditura, që paditëses për 240 ditë të pranisë në punë, për periudhën nga data 21.01.2021 deri më 21.11.2022, t'ia paguajë shpenzimet e ushqimit në shumën 480 €. Si prova, padisë i ka bashkëngjitur: Vërtetimin e lëshuar nga shkolla "A.H.", nr. 74/02, të dates 13.11.2023. Shpenzimet procedurale i ka kërkuar edhe atë shumën 21 € për taksën gjyqësore për padi dhe shumën prej 104 € për përpilimin e padisë.

E paditura, me përgjigje në padi, e ka kundërshtuar si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditëses, me pretendimin se nuk është përgjegjëse për detyrimet nga Kontrata Kolektive e V.t 2017 pasi pagat dhe mëditjet paguhen nga ministria përkatëse e poashtu, tutje ka pretenduar se Qeveria dhe Ministria e Arsimit e kanë shfuqizuar Kontratën Kolektive (tutje KK) të SBASHK-ut, nr. 105, të datës 22.01.2021 si dhe KK paraprake nr. 01B/2056, të datës 21.11.2022 prandaj edhe nuk rrjedh asnjë obligim për të paditurën ndaj paditëses. Lidhur me shpenzimet procedurale, nuk është deklaruar.

Gjykata ka gjetur se asnjë nga faktet e paraqitura në padi nuk janë kontestuese: ekzistimi i marrëdhënies së punës si dhe fakti se paditësja ka qenë e pranishme në punë 240 ditë, pasi e paditura nuk i ka kontestuar këto fakte.

Gjykata ka vlerësuar kushtet ligjore nga neni 398 i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me të cilin është përcaktuar se: “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund të japë aktgjykimin me të cilin e pranon si të themeltë kërkesë padinë” dhe ka ardhur në përfundim se të gjitha kushtet ligjore të përcaktuara në këtë nen janë plotësuar sepse, gjendja faktike nuk është kontestuese e po ashtu nuk ekzistojnë pengesa të tjera që pa caktuar seancë gjyqësore të pranohet si e themeltë kërkesëpadia e paditëses.

Sipas Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), përkatësisht nenit 245, paragrafit 1, është përcaktuar: “Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë të përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”, lidhur me nenin 35, par. 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (tutje KKAK-së), të datës 18.04.2017 dhe KKAK-së të datës 22.01.2021, ku është përcaktuar se: “Të punësuarve u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi, i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restaurantit a kuzhinës ose në një formë tjetër, nuk ka obligim kompensimin për ushqim”, gjykata ka vendosur si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Kundërshtimet e të paditurës janë gjetur të pa bazuara sepse palët kontraktuese të KKAK-së, (Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) dhe Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK)), në nenin 2, par. 1.2., kanë përcaktuar: “Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit (Komunat-DKA, KD të Universiteteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT-in etj.) në sektorin publik dhe institucionet edukativo-arsimore private në mbarë territorin e Republikës

Numri i lëndës:

2024:051630

Datë:

25.03.2024

Numri i dokumentit:

05496988

së Kosovës”. Gjithashtu, neni 37 ka përcaktuar se: “Palët nënshkruese të kësaj kontrate kolektive janë të obliguara që të zbatojnë dhe t’i respektojnë dispozitat e kësaj kontrate”.

Vendimi për kamatën është bazuar në nenin 382 të LMD-së ndërsa, për shpenzimet e procedurës në nenin 452.1 lidhur me procedurat e kontesteve me vlerë të vogël, të përcaktuar në nenin 485.1 të LPK-së dhe numrin tarifor 6 nga Tarifa e Avokatëve të Kosovës, ashtu që gjykata ia ka pranuar shpenzimet paditësit në shumën 78 € për përpilimin e padisë dhe 21 € për taksën gjyqësore për padi, në shumë të përgjithshme 99 €.

Nga të lartcekurat, e duke u mbështetur edhe në nenin 142 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA V.**

**C.nr.859/2024, Datë 22.03.2024**

**Gjyqtari,**

Alush Sinani

**Këshillë Juridike:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në Gjykatën Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afatin prej 7 ditëve pas ditës së pranimit. Ankesa në kopje të mjaftueshme, dorëzohet nëpërmjet kësaj gjykate.